"Çmendet" 34-vjeçari, qëllon me kallashnikov një banesë dhe i rrezikon jetën një familjeje, arrestohet

22 Gusht, 2023 14:04

Madhësia e tekstit:

SKRAPAR

Qëlloi me armë zjarri kallashnikov, brenda një banese, dhe iu rrezikoi jetën anëtarëve të një familjeje, për motive të dobëta, kapet dhe vihet në pranga 34-vjeçari.

Pas marrjes së njoftimit se rreth orës 23:00, të datës 20.08.2023, brenda një banese në fshatin Potom, ishte qëlluar me armë zjarri, shërbimet e Komisariatit të Policisë Skrapar kanë organizuar punën dhe kanë mbërritur menjëherë në vendngjarje, me qëllim arrestimin e autorit.

Si rezultat i veprimeve të shpejta të shërbimeve të Policisë së Skraparit, në bashkëpunim me ato të Forcës së Posaçme Operacionale të DVP Berat, u kap dhe u vu në pranga shtetasi L. T., 34 vjeç, banues në fshatin Potom, Skrapar.

Shtetasi L. T. ka qëlluar me armë zjarri kallashnikov, drejt mureve të banesës së shtetasit S. H., 61 vjeç, për të kanosur anëtarët e familjes së këtij shtetasi, për shkak të një konflikti për motive të dobëta që kishte me ta.

Arma e zjarrit kallashnikov me të cilën u qëllua, dhe 21 fishekë luftarak, u gjetën dhe u sekuestruan nga Policia, në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: kallashnikov policia Skrapar

TË NGJASHME

Shkoi të rrëmbente vajzën që donte, pasi familja nuk pranoi zbrazi kallashnikovin drejt banesës, zbardhen detaje nga ngjarja në Skrapar
Eneida Petova | 22 Gusht, 2023

EMRAT/ Arrestohen 4 persona në Krujë, si e vodhën biznesmenin dhe e kërcënuan me armë të tërhiqte kallëzimin. Policia zbulon se...
22 Gusht, 2023

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Mashtroi 200 koreanë dhe përfitoi 28 mln euro, 61-vjeçari gjerman kërkon lirinë kundrejt garancisë pasurore, ja çfarë vendosi gjykata
22 Gusht, 2023

EMRAT/ Goditi me sende të forta një burrë dhe një grua në Delvinë, shpallet në kërkim 32-vjeçari
22 Gusht, 2023

"Veprim i çmendur", BMW me shpejtësi skëterrë hipi mbi digë, eksperti rrugor: Mund të ketë qenë nën efektin e narkotikëve ose...
22 Gusht, 2023

Aksidenti te diga e liqenit në Tiranë/ "Me shpejtësi mbi 250 km/h", gazetari: Shoferi u pa të largohej i lënduar nga vendngjarja
22 Gusht, 2023

Gjeste të pahijshme në tribunë, thellohet skandali rreth Rubiales, vjen dhe denoncimi i parë
22 Gusht, 2023

"Sterilizimi"/ Një nga të dyshuarit, kushëri i parë i ish-ministrit, anëtar i komisionit të dhënies së koncesionit. SPAK nën hetim Beqjan
Klodiana Lala | 22 Gusht, 2023

KATEGORIA VIDEO

Koncesioni i sterilizimit/ "Asgjë nuk është bërë pa bekimin e Ramës dhe Beqjat", Vokshi: Ish-ministri kërkon të kapet pas fijes së kashtës, por...
22 Gusht, 2023

Mashtroi 200 koreanë dhe përfitoi 28 mln euro, 61-vjeçari gjerman kërkon lirinë kundrejt garancisë pasurore, ja çfarë vendosi gjykata
22 Gusht, 2023

"Veprim i çmendur", BMW me shpejtësi skëterrë hipi mbi digë, eksperti rrugor: Mund të ketë qenë nën efektin e narkotikëve ose...
22 Gusht, 2023

Aksidenti te diga e liqenit në Tiranë/ "Me shpejtësi mbi 250 km/h", gazetari: Shoferi u pa të largohej i lënduar nga vendngjarja
22 Gusht, 2023

Gjeste të pahijshme në tribunë, thellohet skandali rreth Rubiales, vjen dhe denoncimi i parë
22 Gusht, 2023

Nga "Rruga e Kosovarëve" flluturon mbi digë, Velilaj publikon videon e aksidentit: Dënimin maksimal për shoferin!
22 Gusht, 2023

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.